



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e Mirëqenies Sociale
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Munavere Qerkezi, kryesuese, DMS
 2. Lida Visoka, anëtare, QPS
 3. Flutra Reçica, anëtare, DSH
 4. Valbona Ejupi, anëtare, DF
 5. Mehreme Llumnica, anëtare, HANDIKOS
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë të cekura në nenin 7 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Prishtinës 01-020/01-194101/18, dt. 08.08.2018 si dhe nenin 8 të Rregullores MF – nr. 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve.
- IV. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë për Mirëqenie sociale,
- Anëtarëve të Komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti